

# NJOFTIM PËR SHTYP

16/01/2026



## Trajnimi i Trajnerëve: Fuqizimi i profesionistëve të AFP me aftësi të gjelbra në sektorin agro-ushqimor

Rreth 30 mësues dhe profesionistë nga institucionet e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri dhe Kosovë përfunduan me sukses një program të specializuar 14-orësh Trajnimi të Trajnerëve (ToT) mbi aftësitë e gjelbra në sektorin agro-ushqimor. Programi ToT kombinoi një sesion hyrës me sesione të thelluara online dhe detyra të pavarura, duke përfunduar me certifikimin e pjesëmarrësve.

Pjesëmarrësit u bënë pjesë e programit ToT kryesisht të nxitur nga nevoja për të ndërlidhur më mirë aftësitë e gjelbra, modelet e qëndrueshme të biznesit dhe politikat agro-ushqimore me aktivitetet e tyre mësimore. Trajnimi u konsiderua si një mundësi e mirë për t'u njohur me zbatimin praktik të aftësive të gjelbra dhe për të forcuar rrjetet profesionale që mbështesin bashkëpunimin dhe rritjen e kapaciteteve në të ardhmen.

*“Motivi kryesor për t’u bërë pjesë e këtij programi të trajnerëve buron nga nevoja profesionale për të ndërlidhur politikat agro-ushqimore kombëtare dhe evropiane me mësimdhënien praktike në AFP, duke reflektuar tranzicionin e gjelbër dhe objektivat e qëndrueshmërisë”* - Poema Rogova, pjesëmarrëse në programin ToT, Kosovë.

Pavarësisht interesit të lartë, pjesëmarrësit identifikuan disa pengesa kryesore në integrimin e aftësive të gjelbra në arsimin profesional. Këto përfshijnë mospërputhjen e kërkesave të tregut të punës dhe kurrikulave tradicionale të AFP-së, të cilat shpesh nuk reflektojnë mjaftueshëm qëndrueshmërinë, ekonominë qarkulluese, digjitalizimin dhe menaxhimin eficient të burimeve. Po ashtu, sfida mbeten edhe mungesa e materialeve didaktike të standardizuara, qasja e kufizuar në shembuj praktikë nga terreni dhe nevoja për trajnim të vazhdueshëm stafit mësimor.

*“Qasja e përgjithshme është rezultati i shpejtë, që gjeneron menjëherë fitime të mëdha. Zbatimi i aftësive të gjelbra kërkon durim, shpesh kthim në rrënjë dhe kjo e fundit shfaq shpesh problematika: njerëzit kanë ngut të ecin përpara, kanë ngut të shkojnë drejt zhvillimit dhe mendojnë se e kaluara nuk ju duhet tashmë”* - PhD. Brikenë Dionizi, pjesëmarrëse në programin ToT, Shqipëri.

Për t’iu përgjigjur këtyre sfidave, programi ToT i pajisi pjesëmarrësit me njohuri të avancuara mbi aftësitë e gjelbra në sektorin agro-ushqimor, si edhe sesi mund të integrohen këto aftësi në mësimdhënie. Trajnimi përfshiu gjithashtu raste konkrete nga Shqipëria dhe Kosova, duke ndihmuar pjesëmarrësit të përkthejnë kornizat politike në zbatime praktike.

*“Programi më ndihmoi të realizoj objektivat fillestare duke kombinuar raste konkrete nga Shqipëria dhe Kosova me një kuptim më të qartë të politikave agro-ushqimore të BE-së dhe mënyrën se si aftësitë e gjelbra mund të aplikohen si kompetenca praktike dhe të transferueshme në AFP”* - PhD. Brikenë Dionizi, pjesëmarrëse në programin ToT, Shqipëri.

Si rezultat, në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit u ndjenë më të përgatitur për të zbatuar njohuritë e fituara në praktikën e tyre profesionale, duke treguar më shumë besim për të prezantuar përmbajtje inovative në mësimdhënie.

*“Ndjem më e përgatitur për të integruar aftësitë e gjelbra në aktivitetet e mia profesionale, veçanërisht përmes shembujve praktikë të ndarë gjatë trajnimit”* - Poema Rogova, pjesëmarrëse në programin ToT, Kosovë.

Duke u mbështetur në këtë përvojë, pjesëmarrësit sugjeruan disa mënyra për të përmirësuar më tej programe të tilla trajnimi. Rekomandimet kryesore përfshinin rritjen e komponentëve praktikë, si aktivitetet në terren dhe projektet pilot, si dhe përfshirjen më të drejtpërdrejtë të agro-bizneseve dhe institucioneve lokale.

Përmes nismave si ky program ToT, profesionistët e angazhuar në sistemin e AFP fuqizohen për të shërbyer si aktorë të rëndësishëm që sjellin ndryshim, duke nxitur integrimin e aftësive të gjelbra në arsimin profesional. Duke investuar në kapacitetet e tyre, programi ka ndihmuar në krijimin e një sektori agro-ushqimor më të qëndrueshëm.